

Si të sillemi me kritikën ndaj Islamit?

Hyrje

Përballja me kritikën ndaj Islamit përbën një komponent qendror të diskursit fetar dhe shoqëror-politik në Evropë. Ndërsa, nga njëra anë, kritika legjitime dhe e diferencuar ndaj shfaqjeve të caktuara fetare mund të jetë e domosdoshme dhe frytdhënëse, nga ana tjetër, qëndrimet përgjithësuese dhe armiqësore ndaj Islamit dhe muslimanëve janë shfaqur gjithnjë e më problematike. Qëllimi i këtij punimi është t'i sqarojë bazat konceptuale, ta skicojë zhvillimin historik të kritikës ndaj Islamit dhe të paraqesë mundësi për një qasje konstruktive ndaj kritikës së lidhur me Islamin.

Sqarimi i disa koncepteve:

Islamofobia

Islamofobia përkufizohet si një ndjenjë e theksuar frike dhe kërcënimi, e drejtuar ndaj Islamit ose ndaj muslimaneve dhe muslimanëve, e cila e tejkalon dukshëm masën që konsiderohet shoqërisht "normale". Ky dispozitiv frike, zakonisht, nuk mbështetet në njohuri të diferencuara, por në interpretime përgjithësuese dhe stereotipizuese.

Tipare karakteristike të modeleve islamofobike të perceptimit janë, veçanërisht, paraqitja e Islamit si një strukturë monolitike dhe statike, si thelbësisht e huaj për shoqërinë përkatëse, si përbrendësisht agresive dhe si inferiore në aspektin kulturor ose moral.

Një shembull ilustrues për këtë janë fushatat politike të aktorëve të ekstremit të djathtë, siç ishte p.sh. slogani "*Maria në vend të Sherias*". Parulla të tilla janë të konceptuara qëllimisht në mënyrë armiqësore ndaj Islamit dhe synojnë mobilizimin e emocioneve, e jo të argumenteve. Efekti i tyre shfaqet kryesisht në prodhimin e frikërave iracionale te publiku, veçanërisht në përfytyrimin e një gjoje islamizimi kërcënues të Evropës nga ana e muslimanëve.

Armiqësia ndaj Islamit

Armiqësia ndaj Islamit nënkupton një qëndrim thelbësisht dhe rigorozisht refuzues ndaj Islamit si fe. Karakteristike për të është perceptimi i përgjithësuar dhe i padiferencuar i

Islamit si kërcënim shoqëror, kulturor ose politik, i cili – sipas këtij supozimi – duhet të luftohet aktivisht për ta mbrojtur sistemin e vet të vlerave.

Deklarata tipike në këtë kontekst janë, për shembull: “*Islami është një sistem autoritar dhe arkaik dhe i papajtueshëm me vlerat dhe strukturat demokratike.*” Atribuime të tilla operojnë me përgjithësime dhe e injorojnë larminë e brendshme islame, si dhe diferencimet historike e kontekstuale.

Ndër aktorët politikë më të rëndësishëm që sot përhapin narrativa armiqësore ndaj Islamit përfshihen veçanërisht partitë ekstremiste dhe populiste të djathta në Evropë. Mobilizimi i figurave armiqësore ka qenë prej kohësh një instrument qendror i agjitacionit të tyre politik.

Modele të ngjashme interpretimi gjenden, me intensitet dhe mprehje gjuhësore të ndryshme, edhe në platforma të shumta digjitale me shtrirje të gjerë, ku riprodhohen imazhe negative dhe të shtrembëruara të Islamit. Këto hapësira diskursive digjitale kontribuojnë ndjeshëm në ngurtësimin e qëndrimeve armiqësore ndaj Islamit në perceptimin publik.

Ndërsa *islamofobia* përshkruan kryesisht një ndjenjë frike dhe kërcënimi, të bazuar në perceptime stereotipe dhe të thjeshtuara, *armiqësia ndaj Islamit* nënkupton një qëndrim ideologjikisht të konsoliduar dhe thelbësisht refuzues ndaj Islamit si fe, i cili shihet si rrezik shoqëror ose politik dhe synohet të luftohet në mënyrë aktive. *Islamofobia* mbështetet kryesisht në frikëra iracionale, ndërsa *armiqësia ndaj Islamit* shfaqet si refuzim i vetëdijshëm, argumentues dhe shpesh i instrumentalizuar politikisht.

Kritika ndaj Islamit

Kritika ndaj Islamit është një term me përdorim shumëplanësh, i cili në diskursin publik merr kuptime të ndryshme, herë-herë edhe kontradiktore.

Nga njëra anë, aktorë me qëndrime armiqësore ndaj Islamit vetëpërkufizohen si “kritikë të Islamit”, pasi ky term është më pak negativisht i ngarkuar dhe ofron më shumë mundësi pranimi shoqëror. Ky vetë-emërtim shërben shpesh për legjitimimin diskursiv të refuzimit të përgjithshëm. Nga ana tjetër, përfaqësues të organizatave islame ose studiues të paragjykimeve ndonjëherë u atribuojnë kritikëve të caktuar të Islamit një armiqësi të fshehur ndaj tij. Ky tension tregon paqartësinë konceptuale dhe potencialin e lartë konfliktual të termit në fjalë.

Një përkufizim sa më i saktë e kupton kritikën ndaj Islamit si një përballje me shfaqje, interpretime ose fenomene të caktuara shoqërore të Islamit, pa e refuzuar fenë në tërësi si figurë armiqësore. Vendimtare është dallimi ndërmjet kritikës ndaj fenomeneve konkrete dhe refuzimit të Islamit si tërësi.

Njëkohësisht, duhet theksuar se kritika ndaj Islamit nuk paraqitet domosdoshmërisht në formë të diferencuar, teologjike ose sociologjike. Shpesh ajo nuk përbën punë me pretendim shkencor, por raporte të përvojave subjektive, reflektime personale ose ese publicistike.

Armiqësia ndaj muslimanëve ose racizmi antimusliman

Armiqësia ndaj muslimanëve dallon thelbësisht nga konceptet e trajtuara më sipër, pasi nuk i referohet Islamit si fe, por muslimaneve dhe muslimanëve si bartës të saj. Ky dallim është thelbësor nga perspektiva e të drejtave të njeriut, sepse jo mësimet ose sistemet fetare, por njerëzit janë bartës të të drejtave themelore dhe njerëzore.

Armiqësia ndaj muslimanëve ose racizmi antimusliman shkon përtej qëndrimeve individuale armiqësore: ai duhet kuptuar si marrëdhënie shoqërore e zhvilluar historikisht. Ajo karakterizohet nga modele mendimi, perceptimi dhe veprimi që prodhojnë dallim dhe tjetërsi, duke krijuar dhe legjitimuar raporte pushteti dhe pabarazie.

Në procesin e racizimit, njerëzit muslimanë – ose ata që perceptohen si të tillë – shihen si një grup homogjen me tipare të pandryshueshme, pavarësisht nëse vetidentifikohen apo jo si muslimanë.

Racizmi antimusliman shfaqet, ndër të tjera, në mohimin e pluralitetit: ndërsa grupi vetjak përfytyrohet si heterogjen, muslimanët reduktohen në fenë e tyre dhe injorohen dimensionet e shumta të identitetit të tyre. Kjo sugjeron se të gjithë muslimanët ndajnë vlera të njëjta ose madje qëndrime politike identike. Shpesh u atribuohen në mënyrë përgjithësuese homofobia, seksizmi, antisemitizmi, rezistenca ndaj demokracisë ose prirje ndaj dhunës.

Po ashtu, racizmi antimusliman konsiston në atribuimin *a priori* të një “natyre” të caktuar muslimanëve, duke u mohuar atyre çdo potencial zhvillimi dhe ndryshimi. Nëse muslimanët shprehin moskuptim ndaj polemikave, p.sh. për simbole fetare për ta të rëndësishme, kjo interpretohet si provë e paaftësisë së tyre për kritikë dhe rrjedhimisht, si dëshmi e papajtueshmërisë së tyre me vlerat e konsideruara si “evropiane”.

Kritika ndaj muslimanëve

Kritika ndaj muslimanëve nënkupton vënien në dukje kritike të tipareve, qëndrimeve ose sjelljeve – reale apo të supozuara – të besimtarëve muslimanë. Ndryshe nga atribuimet përgjithësuese, kjo formë kritike nuk drejtohet domosdoshmërisht kundër muslimanëve si të tillë, por ndaj fenomeneve specifike brenda grupit të besimtarëve muslimanë.

Anëtarët e grupeve shoqërore, pavarësisht dallimeve të tyre sipas moshës, profesionit, nivelit arsimor, praktikës fetare, statusit shoqëror ose orientimit politik, shfaqin gjithmonë modele dhe veçori të caktuara. Trajtimi kritik i këtyre tipareve nuk përbën vetvetiu qëndrim armiqësor ndaj të gjithë grupit, për sa kohë që kritika mbetet e diferencuar dhe nuk operon me përgjithësime.

Kritika ndaj muslimanëve synon, pra, qëndrime, praktika ose problematika konkrete brenda komuniteteve muslimane.

Dallimi analitik ndërmjet *armiqësisë ndaj muslimanëve* dhe *kritikës ndaj muslimanëve* është thelbësor për një diskurs publik të arsyeshëm, sepse mundëson formulimin e

kritikës legjitime ndaj fenomeneve shoqërore konkrete pa rënë në përgjithësimë diskriminuese ose shkelëse të të drejtave të njeriut.

Historia e kritikës ndaj Islamit

Përballja me kritikën i përket historisë së të gjitha traditave fetare. Asnjë pejgamber i dërguar nga Zoti nuk është pritur pa rezerva, «me lule apo me tepik të kuq», në historinë e njerëzimit; përkundrazi, mesazhet e reja fetare janë shoqëruar pothuajse gjithmonë nga skepticizmi, refuzimi dhe armiqësia e hapur. Në këtë kuptim, kritika fillestare ndaj ideve të reja fetare, normave etike ose projekteve të reformës shoqërore duhet kuptuar si proces shoqëruar historikisht “normal” i fazave të transformimit fetar.

As Islami nuk përbën përjashtim. Që nga periudha e formimit të bashkësisë islame në shekullin VII, kritika ndaj Islamit ka ekzistuar në forma dhe në nivele të ndryshme. Qysh në Mekë, mesazhi islam u refuzua nga elitat arabe për arsye politike, ekonomike dhe fetare. Përveç kësaj, edhe bashkëkohës hebrenj dhe të krishterë të Islamit të hershëm formuluan kundërshtime teologjike ndaj pohimeve qendrore të besimit, të cilat vazhduan të ndikojnë në literaturën polemike të mëvonshme.

Gjatë historisë, kritika ndaj Islamit u zhvillua edhe mbi baza filozofike, etike dhe shkencore. Brenda konteksteve më të gjera të historisë së ideve – p.sh. në debatet mbi arsyen, shpalljen dhe të drejtën natyrore – Islami, ashtu si fetë e tjera, u bë objekt reflektimesh racionale dhe skeptike. Veçanërisht traditat ateiste dhe kritikët e fesë e drejtuan kritikën e tyre në mënyrë të përgjithshme kundër botëkuptimeve fetare, e jo ekskluzivisht kundër Islamit.

Në epokën moderne dhe bashkëkohore vërehet gjithashtu një rritje e zërave kritikë nga vetë konteksti islam ose musliman. Këtu përfshihen muslimanë sekularë, intelektualë reformistë dhe ish-muslimanë që i vënë në pikëpyetje mësimet fetare, strukturat institucionale ose praktikën e caktuara shoqërore islame. Këto forma kritike dallojnë ndjeshëm për nga motivimi, argumentimi dhe qëllimi dhe nuk duhen barazuar në mënyrë të përgjithshme.

Së fundi, paralelisht me kritikën e Islamit është zhvilluar edhe një *kritikë e kritikës ndaj Islamit*. Ajo reflekton mbi parakushtet metodologjike, normative dhe politike të diskurseve islamkritike dhe pyet nëse forma të caktuara kritike synojnë më pak analizën objektive dhe më shumë ndërtimin e figurave armiqësore, kufizimin kulturor ose instrumentalizimin politik. Perspektiva historike tregon, kështu, se kritika ndaj Islamit nuk është një fenomen i njëtrajtshëm, por një diskurs shumëplanësh, i varur nga konteksti dhe i ndryshueshëm, i vendosur gjithmonë në fushën e tensionit ndërmjet interesimit për të njohur apo mësuar, raporteve të pushtetit dhe proceseve shoqërore të negocimit.

Kritika e brendshme e Islamit

Kritika e brendshme përbën një komponent themelor të historisë së besimit, mendimit dhe shkencës islame. Përkundër supozimeve të përhapura, Islami nuk është një traditë

rezistente ndaj kritikës apo monolitike, por disponon mekanizma të shumtë të vetëreflektimit, korrigjimit dhe ripërtëritjes.

Vetë Kur'ani mban një qëndrim kritik: ai e kritikon njeriun për dobësitë e tij morale, disa pejgamberë për gabimet e tyre njerëzore, popujt e mëparshëm për mendjemadhësinë ose padrejtësinë e tyre, si dhe forma të ndryshme të devijimit dhe absolutizimit fetar. Po ashtu, kleri fetar i bashkësive të mëparshme kritikohet shprehimisht për shpërdorim pushteti dhe shtrembërim të përgjegjësisë fetare.

Një fushë qendrore e kritikës së brendshme islame është marrëdhënia ndërmjet Kur'anit dhe literaturës së hadithit. Që nga shekujt e parë kanë ekzistuar debate intensive mbi autenticitetin, zinxhirët e transmetimit (*isnad*), koherencën përmbajtësore (*metn*) dhe shtrirjen normative të haditheve të veçanta. Këto diskutime çuan në zhvillimin e shkencave të sofistikuara të hadithit dhe dëshmojnë se kritika nuk u perceptua si kërcënim, por si instrument i domosdoshëm i kërkimit të së vërtetës fetare.

Ngushtë e lidhur me këtë është edhe shumëllojshmëria e komentimeve (*tefsireve*) kur'anore. Qasje të ndryshme gjuhësore, teologjike, juridike, mistike dhe filozofike tregojnë se Kur'ani kurrë nuk ka prodhuar vetëm një lexim të vetëm, të përjetshëm. Përkundrazi, interpretimet e ndryshme i pasqyrojnë gjithmonë kontekstet historike, kulturore dhe intelektuale të interpretuesve.

Kritika e brendshme islame u formësua gjithashtu edhe nga kontakti i dijetarëve muslimanë me fe, kultura dhe tradita filozofike të tjera. Ballafaqimi me mendimin hebraik dhe të krishterë, me filozofinë greke, si dhe me botën mendore e shpirtërore perse dhe indiane, solli debate frytdhënëse mbi arsyen, shpalljen, etikën dhe metafizikën.

Një zhanër klasik i kritikës së brendshme islame është tradita e *reddijjeve* ("kundërpërgjigjeve"), në të cilat dijetarët muslimanë u përballën në mënyrë argumentuese me pozicione teologjike, filozofike ose juridike të shkollave të tjera, si brenda Islamit ashtu edhe ndaj rrymave të jashtme.

Rëndësi e veçantë i takon edhe traditës filozofike të literaturës *tehafut*. Në këtë kontekst, el-Gazaliu (v. 1111) shkroi veprën *Tehafut el-felasife* ("Vetëshkatërrimi i filozofëve"), ku kritikoi disa supozime metafizike të filozofëve islamë. Si përgjigje, Ibn Rushdi (Averroes, v. 1198) shkroi *Tehafut et-tehafut* ("Vetëshkatërrimi i vetëshkatërrimit"), një mbrojtje sistematike e racionalitetit filozofik. Ky debat konsiderohet edhe sot si shembull paradigmatic i polemikës intelektuale islame në nivelin më të lartë të mundshëm njerëzor.

Së fundi, kritika e brendshme manifestohet edhe në konceptin e *ixhtihadit*, gjykimit juridik të pavarur. Shkollat e ndryshme juridike islame (*medh'hebet*) janë shprehje e interpretimeve pluraliste të të njëjtave burime dhe tregojnë se larmia juridike dhe debatet normative janë pjesë përbërëse e kulturës juridike islame.

Perspektiva të zgjeruara për mënyrën e trajtimit të kritikës ndaj Islamit

1. Nga justifikimi reaktiv drejt kompetencës sovrane diskursive dhe formësuese

Një model i përhapur në përballjen me kritikën ndaj Islamit është qëndrimi kryesisht reaktiv: kritika merret në përgjigje, relativizohet ose refuzohet. Megjithatë, në plan afatgjatë, më efektiv rezulton ndërtimi i kompetencës diskursive dhe formësuese. Kjo kompetencë nuk përfshin vetëm ballafaqimin përmbajtësor me kritikën, por edhe aftësinë për ta analizuar burimin e saj, qëllimin dhe strukturën argumentuese.

Në këtë kuadër, është thelbësore të bëhen dallime të qarta:

- ndërmjet kritikës së orientuar drejt njohjes dhe provokimit identitar-politik,
- ndërmjet shqetësimit individual dhe modeleve strukturore të diskursit,
- ndërmjet kritikës ndaj normave dhe sulmeve personale.

Një kompetencë e tillë diskursive mundëson që të mos reagohet ndaj çdo provokimi, por të flitet në mënyrë të qëllimshme aty ku dialogu është i mundshëm dhe produktiv.

Njëkohësisht, një përballje e reflektuar me kritikën ndaj Islamit kërkon një ndryshim të vetëdijshëm të narrativës: larg diskursit të përhershëm të justifikimit ("A është Islami demokratik, paqësor apo modern?"), drejt një diskursi formësues, në të cilin muslimanët i vendosin vetë temat e tyre. Këtu bëjnë pjesë, për shembull, pyetjet mbi kontributet etike të mendimit islam në drejtësi klimatike, përgjegjësi shoqërore apo etikë digjitale, mbi pasurimin e shoqërive pluraliste përmes perspektivave muslimane, si dhe mbi shembujt pozitivë tashmë ekzistues të praktikës së jetës muslimane.

Ky ndryshim perspektive e forcon rolin e muslimaneve dhe muslimanëve si bashkëformësues aktivë të së ardhmes shoqërore. Ai presupozon që të mos bihet në një rol viktimizues apo në një mentalitet viktimor, pasi një vetëpozicionim i vazhdueshëm si grup i marginalizuar mund ta kufizojë aftësinë për veprim dhe ndikim konstruktiv. Në vend të kësaj, vetëdija për vlerën tonë, aftësia dialoguese dhe qartësia argumentuese përbëjnë parakushte themelore për një prani sovrane dhe të denjë në diskursin publik.

2. Vetëkritika si forcë – jo si dobësi

Një trajtim më përparimtar i kritikës ndaj Islamit nënkupton edhe pranimin e vetëdijshëm të pikave legjitime të kritikës. Problemet brenda bashkësive muslimane – si p.sh. struktura patriarkale, deficitet arsimore, interpretimi autoritar i fesë ose mungesa e transparencës së institucioneve fetare – nuk duhet të eksternalizohen apo të relativizohen në mënyrë refleksive.

Vetëkritika këtu nuk duhet kuptuar si përshtatje ndaj presionit të jashtëm, por si vijimësi e traditës së kritikës së brendshme islame (*ixhtihadi*, diskurset reformuese). Ajo e forcon besueshmërinë e zërave muslimanë në hapësirën publike dhe pengon që kritika e arsyeshme të artikullohet vetëm nga jashtë.

3. Shkëputja e identitetit nga kritika

Një hap i rëndësishëm është që kritika ndaj Islamit të mos interpretohet automatikisht si sulm ndaj identitetit tonë. Nëse çdo pohim kritik përjetohet si sulm ndaj vetes ose ndaj komunitetit, krijohet një gjendje e përhershme mbrojtëse që e bllokon dialogun.

Ne muslimanët mund të mësojmë të dallojmë ndërmjet:

- kritikës ndaj normave fetare,
- kritikës ndaj praktikave shoqërore,
- kritikës ndaj aktorëve politikë, dhe
- kritikës ndaj identitetit fetar ose personal.

Kjo shkëputje na mbron nga mbingarkesa emocionale dhe krijon hapësirë për një ballafaqim të kthjellët e racional.

4. Arsimi si strategji kyçe

Një problem i rëndësishëm është se muslimanet dhe muslimanët në hapësirën publike shpesh perceptohen si përfaqësues kolektivë të Islamit. Prej tyre pritet në mënyrë implicite që të jenë gjithnjë ekspertë për çështje teologjike, zhvillime historike, konflikte politike, si edhe për vendet e origjinës dhe kulturat e tyre. Kjo pritshmëri jo vetëm që është jorealiste, por edhe problematike në aspektin normativ, sepse nuk e merr parasysh identitetin individual fetar dhe i shtyn muslimanët në një pozicion të vazhdueshëm justifikues.

Po aq e rëndësishme është të kuptohet se askush nuk është i detyruar të zotërojë dije gjithëpërfshirëse mbi Islamin apo të paraqitet si ekspert fetar. Është legjitime dhe e arsyeshme që, në çështje të ndërlikuara teologjike ose historike, të referohen persona të kualifikuar: imamë, teologe, teologë ose studiues. Kjo ndarje rolesh e lehtëson individin dhe, njëkohësisht, e rrit cilësinë profesionale të diskursit.

Në plan afatgjatë, kritika ndaj Islamit mund të trajtohet konstruktivisht vetëm aty ku arsimimi nxitet në të dyja anët. Për ne muslimanët kjo nënkupton:

- bazë të qëndrueshme të edukimit fetar,
- kontekstualizim historik të teksteve fetare,
- njohuri mbi kornizat sekulare, juridike dhe shoqërore.

Muslimanët e informuar mirë mund të argumentojnë më saktë e në mënyrë më të diferencuar, t'i demaskojnë shkurtime populiste dhe të lëvizin me sovranitet në diskursin publik – pa u bërë misionarë apo apologjetë.

5. Ndërtimi i koalicioneve dhe aleancave

Një qasje më e gjerë ndaj kritikës së Islamit është që ajo të mos shihet si problem i izoluar “musliman”. Shumë narrativa që sot drejtohen kundër muslimanëve u ngjajnë diskurseve të mëhershme kundër pakicave të tjera fetare ose kulturore.

Prandaj, nga pikëpamja strategjike, është e arsyeshme të ndërtohen aleanca:

- me aktorë hebrenj, të krishterë ose laikë dashamirës,

- me organizata të të drejtave të njeriut,
- me shkencën, mediat dhe shoqërinë civile.

Qëndrimet e përbashkëta kundër racizmit, diskriminimit dhe populizmit e forcojnë kulturën demokratike në tërësi dhe e lirojnë komunitetin musliman nga roli i “mbrojtësit të vetëm”.

6. Pjesëmarrja shoqërore

Ne, muslimanet dhe muslimanët, nuk duhet të shfaqemi vetëm si objekt i debateve publike, por si aktorë aktivë të proceseve shoqërore. Angazhimi në shoqata muslimane, organizata joqeveritare, iniciativa të shoqërisë civile ose parti politike mundëson dukshmëri, bashkëformësim dhe përgjegjësi. Përmes kësaj pjesëmarrjeje aktive, kritika ndaj Islamit nuk “përgjigjet” thjesht, por vendoset brenda një procesi më të gjerë demokratik të negocimit shoqëror.

7. Qetësia si shenjë e pjekurisë fetare dhe demokratike

Së fundi, pjesë e një trajtimi të pjekur të kritikës ndaj Islamit është edhe qetësia. Jo çdo kritikë kërkon përgjigje. Jo çdo provokim meriton vëmendje. Sovraniteti fetar dhe shoqëror shfaqet edhe në aftësinë për t'i duruar ambivalencat dhe për të mos e interpretuar kritikën si kërcënim ekzistencial.

Kjo qasje lidhet si me parime etike islame (*hilm* – butësi, maturi, vetëpërmbajtje e qetë; *sabr* – durim, qëndrueshmëri, këmbëngulje; *hikmeh* – urtësi, gjykim i mençur), ashtu edhe me përfytyrime bashkëkohore të pluralizmit në teorinë demokratike.

Në këtë sfond, është me rëndësi të veçantë që kritika ndaj Islamit të mos tabuizohet dhe as të shmanget. Kritika është pjesë e domosdoshme e shoqërive pluraliste dhe duhet të përballohet edhe prej nesh muslimanëve. Prania e saj nuk duhet parë parësisht si sulm, por si shenjë e normalizimit shoqëror: Islami – ashtu si fetë e tjera – bëhet objekt debatesh publike, kundërthëniesh dhe ballafaqimesh. Refuzimi i diskursit, në plan afatgjatë, do të çonte më tepër në marginalizim sesa në njohje publike të Islamit.

Me pak fjalë, një qasje e orientuar nga e ardhmja ndaj kritikës së Islamit kërkon diferencim analitik, gatishmëri për reformë të brendshme, vetërregullim emocional, pjesëmarrje aktive shoqërore, si dhe guximin që diskursi jo vetëm të përgjigjet, por edhe të bashkëformësohet.

Përfundim

Analiza tregoi se termi “kritikë ndaj Islamit” mund të përdoret në mënyrë kuptimplote dhe konstruktive vetëm atëherë kur dallohet qartë nga islamofobia, armiqësia ndaj Islamit dhe racizmi antimusliman. Ndërsa diskursat përgjithësuese dhe armiqësore mbështeten në frikë, ideologjizim dhe asimetri pushteti, kritika e diferencuar ndaj mësimave fetare, praktikave shoqërore ose strukturave institucionale është një komponent legjitim dhe i domosdoshëm i shoqërive pluraliste.

Nga perspektiva historike, kritika nuk është trup i huaj në Islam, por element përbërës i traditës së tij fetare, juridike dhe intelektuale. Si kritika e brendshme islame – p.sh. në ekzegjezën e Kur'anit, në shkencat e hadithit, në pluralitetin juridik dhe në filozofi – ashtu edhe ballafaqimet e jashtme dëshmojnë se Islami kurrë nuk ka ekzistuar si sistem i ngurtë ose rezistent ndaj kritikës. Përkundrazi, ai ka qenë gjithnjë i përfshirë në procese dinamike interpretimi, reformimi dhe negocimi.

Për kontekstin shoqëror bashkëkohor, kjo do të thotë se muslimanet dhe muslimanët nuk duhet as ta refuzojnë në mënyrë reflektive kritikën ndaj Islamit, as ta internalizojnë atë pa kriter. Një qasje e orientuar nga e ardhmja kërkon kompetencë diskursive, aftësi vetëkritike, distancim emocional nga sulmet përgjithësuese dhe ndarje të vetëdijshme mes kritikës ndaj përmbajtjes dhe sulmeve ndaj identitetit. Vendimtare është kalimi nga një diskurs mbrojtës i justifikimit në një diskurs aktiv formësimi, ku perspektivat muslimane sjellin me vetëbesim tema, vlera dhe kontribute në hapësirën publike.

Në plan afatgjatë, një trajtim konstruktiv i kritikës ndaj Islamit mund të realizohet vetëm nëse forcohen arsimi, pjesëmarrja shoqërore dhe aleancat ndërfetare e qytetare. Kritika ndaj Islamit nuk duhet kuptuar parësisht si kërcënim, por si shprehje e normalizimit shoqëror: Islami – si fetë e tjera – bëhet objekt debatesh publike, kundërthëniesh dhe kritikash. Ta përballosh këtë, ta formësosh në mënyrë të diferencuar dhe të ndikosh aktivisht në të, është shenjë pjekurie fetare dhe përgjegjësie demokratike.

Literatura e përdorur:

- Armin Pfahl-Traughber, “Islamfeindlichkeit, Islamophobie, Islamkritik – ein Wegweiser durch den Begriffsdschungel”, www.bpb.de
- *TANGRAM*, 40, Buletin i EKR, Dhjetor 2017, “Muslimenfeindlichkeit: Gesellschaft, Medien und Politik”, www.ekr.admin.ch
- “Wo endet Islamkritik und beginnt Islamfeindlichkeit?” Intervistë me Farid Hafez, www.bpb.de
- Marshall B. Rosenberg, *Gewaltfreie Kommunikation: Eine Sprache des Lebens*, Junfermann Verlag, 2012.
- Noemi Truco, Asmaa Dehbi, Amir Dziri, Hansjörg Schmid, *Antimuslimischer Rassismus in der Schweiz: Grundlagenstudie*, Fribourg: SZIG/CSIS, 2025.